



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4868 Prot

Gramsh më, 07.01.2021, 12.2020

V E N D I M

Nr. 85 dt. 28/12/2020

“ Për miratimin vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Estref Dollenga, banues në fshatin Irmenj, Njësia Administrative Tunjë, si dhe dëmshpërblim financiar”.

Këshilli i bashkisë në mbledhjen e tij të datës 28 /12/2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit : “ Për miratimin vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Estref Dollenga, banues në fshatin Irmenj, Njësia Administrative Tunjë, si dhe dëmshpërblim financiar”, bazuar në :

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th.  $1\ 675\ 790 \times 50\% = 837\ 895$  lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Estref Dollenga** është në 837 895 (tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë ) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej 837 895 (tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë ) lekë, për shtetasin **Z. Estref Dollenga**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektor i Emergjencave Civile ).
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**

**XHULIA GJINI**

Konceptoi: Xh. Gjini

Miratoi : G.Lena

Pranoi: G.Lena

Dosja nr: \_\_\_\_\_

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**GRETA LENA**

